

VENDIM
Nr. 122, datë 4.6.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
(OSHEE SHA), MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 112, DATË
8.7.2016 E VLEFSHME DERI MË DATË 8.7.2021 TE SHOQËRIA “FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL” SHA
(FSHU SHA)**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “d”; 37, pika 2, germa “c” dhe nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2 dhe 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “c”; 5, pika 1, germa “c”; 10, pika 3; 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 te shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), e vlefshme deri në datën 8.7.2021,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e licencave/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a. dhe me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018 shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.).

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar pranë ERE-s në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016.

- Me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 6.4.2018, OSHEE sh.a. ka bërë me dije themelimin e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë OSHEE sh.a. në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3, gjerat “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa “d” (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.) Diagrama e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektives – Subjekti nuk deklaron që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.

- Neni 17, pika 4, germa “a” (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 germa “a” (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatim – taksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);

- Nenin 17, pika 4, germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës), do të njoftohet shoqëria që në bazë të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” neni 11, pika 1, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës së Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 e vlefshme deri me datë 8.7.2021, të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.),

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti